

# LEERPROJECT

## (PROJEKT MËSIMI)

- je midis 12 dhe 18 vjeç
- dhe je në telashe sepse kalove cakun
- dhe ti e di këtë

Si rrjedhojë duhet të ndjekësh një projekt mësimi për të bërë të mundur që tani e tutje ti do të respektosh rregullat dhe kufijtë e të tjerëve.

Së bashku ne do të shikojmë midis të tjerave: çfarë vajti keq, pse ndodhi kjo dhe çfarë mund të bësh në të ardhmen për të mënjeluar diçka të tillë.

## SI

### Kjo...

bëhet me anë të bisedave javore me udhëzuesin tënd ose pjesëmarrjen aktive dhe kreative në sesionet në grup me te rinj që ndodhen në një situatë të ngjashme me tënden. Çdo i ri është ndryshe, prandaj çdo i ri do marrë udhëzimin e përshtatshëm. Në përcaktimin e trajektit tënd ne kemi parasysh se çfarë të duket ty e rëndësishme, por do dëgjojmë edhe dëshirat e prindërve të tu dhe të personit që të ka referuar tek ne.

### Nga gabimet mund të nxjerrësh mësimë...

Ne do të shikojmë nga afër çfarë ka ndodhur dhe do të flasim edhe për dëmin që ke shkaktuar ti: dëmin e shkaktuar ndaj viktimës, ndaj vetes tënde dhe njerëzve rreth teje. Në këtë mënyrë ne do të mundohemi të evitojmë përfshirjen tënde në të ardhmen, në situata të tilla të vështira.

## Si përfundim

Një projekt mësimi është i sukseshëm nëse...

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "LEERPROJECT" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "LEERPROJECT".

- ti tregon mjaftueshëm dedikim dhe motivim, kjo do të thotë që ti mendon dhe je i përfshirë në mënyrë aktive.
- je gjithnjë i përpiktë në orar.
- respekton marrëveshjet.
- ke kuptuar veprat e kryera si edhe pasojat për veten tënde, viktimën dhe njerëzit pranë teje.
- ti e di që je përgjegjës për sjelljen tënde dhe pasojat e saj.
- ke kuptuar rëndësinë e bërjes së zgjedhjeve në sjelljen tënde.
- mund të tregosh se deri ku e ke kufirin dhe kupton se deri ku e kanë të tjerët.
- nuk kryen më vepra të tjera.

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "LEERPROJECT" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "LEERPROJECT".